



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:153047
Datë: 22.02.2024
Numri i dokumentit: 05359267

C.nr.258/2019

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtari Baki Shigjeqi, me praktikantin D.H. duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania “ C.....”, me seli në Prishtinë, e të cilës sipas autorizimit e përfaqëson V.H. nga Prishtina, kundër të paditurit Sh.Q. me numër personal me vendbanim lagjen “D.....”, tek në Prizren, për shkak të rimbursimit të dëmit, vlera e kontestit 1,284.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të përfaqësueses së paditëses dhe të paditurit, me datën 20.02.2024 mori, ndërsa me datë 22.02.2024 përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS”, me seli në Prishtinë, ashtu që **DETYROHET** i padituri Sh.Q. nga Prizreni, që në emër të rimbursimit të dëmit ti paguaj paditëses shumën prej 1,284.00 euro, me kamat ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste, mbi një vit pa destinim të caktuar, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja me datë 27.02.2019, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për rimbursimin e dëmit, kundër të paditurit Sh.Q. nga Prizreni. Ka theksuar se i padituri me datë 08.08.2016, rreth orës 17:45 në Prizren, ka shkaktuar aksident trafik, duke e drejtuar nga pakujdesia automjetin e markës Ford Sierra, me targa të regjistrimit me ç’rast si pasojë e këtij aksidenti dëme materiale dhe lëndime trupore kanë pësuar të dëmtuarit V.P. dhe E.R. Automjeti, i cili ka qenë shkaktar i këtij aksidenti, në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë sigurie, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Meqenëse Byroja Kosovare e Sigurimeve,

bazuar në dispozitat e LMD dhe LSDA, të dëmtuarve V.P. dhe E.R. i ka kompensuar dëmin, të shkaktuar nga i padituri Sh.Q. me automjeti Ford Sierra, bazuar në dispozitat ligjore të ligjeve të lartcekura ka të drejtë në rimbursim të mjeteve, andaj nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses.

Po ashtu edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, e autorizuar e paditëses V.H. ka qëndruar pranë pretendimeve të cekura në padi, dhe ka konsideruar se ka prova të mjaftueshme që të miratohet kërkesëpadia e paditëses BKS si e bazuar, dhe që të detyrohet i padituri, që paditëses t'ia rimbursoj shumën prej 1,284.00 euro. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurit Sh.Q., nuk ka paraqitur përgjigje në padi, ndërsa në shqyrtimin përgatitor-kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar nuk e konteston kërkesëpadinë e paditëses, nuk është kontestues fakti që ka ndodhur aksidenti i komunikacionit me datën 08.08.2016, dhe se nga ky aksident rrjedh dëmi i pësuar nga të dëmtuarit V.P. dhe E.R. të cilin e ka kompensuar paditësja BKS. Tutje ka shtua se ndodhet në vuajtje të dënimit në Burgun e Dubravës dhe se nuk ka mjete për rimbursimin e dëmit.

2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: leximi i raportit policor të aksidentit me numër 2016-GR-0609, i datës 08.08.2016, ka bërë leximin e konfirmimit të policës së sigurimit me numër TPL:3894645 lëshuar më datën 09.11.2011 në emër të të siguruarit I.B. ka bërë leximin e ujdisë jashtëgjyqësore me nr.1136/2016 datë 08.06.2017, leximin i urdhër-transferit bankar e datës 09.06.2017, leximin e ujdisë jashtëgjyqësore me nr.1140/2016 datë 06.12.2016, leximin i urdhër-transferit bankar i datës 30.01.2017, leximin e ujdisë jashtëgjyqësore me nr.1137/2016 datë 01.11.2016, leximin i urdhër-transferit bankar e datës 15.12.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se:

kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Nga leximi i raportit policor të aksidentit me numër 2016-GR-0609, i datës 08.08.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se ka ndodhur aksident trafiku, ku deri te aksidenti kishte ardhur ku vozitësi i veturës Ford Sierra me targa i cili ishte nën ndikimin e alkoolit dhe narkotikëve, derisa ishte duke lëvizur përgjatë rrugës “ Papa Gjon Pali i II”, me të arritur në kryqëzimin me rrugën “Aleksadër Flemingu”, merë veprimi për kthinë djathtas , me ç'rast e humb kontrollin mbi veturë, duke i goditur veturat e parkuara të evidentuar si vetura, B,C dhe D, të cilave u ka shkaktuar dëme materiale.

Nga leximi në konfirmimit të policës së sigurimit me numër TPL:3894645 lëshuar më datën 09.11.2011 në emër të të siguruarit I.B. gjykata ka vërtetuar faktin se vetura e të paditurit, Ford

Sierra me targa ka pasur validitet të policës së sigurimit nga data 08.11.2011 deri më datë 08.11.2012, dhe se në kohën e shkakimit të aksidentit ka qenë pa mbulesë sigurimi.

Nga leximi i ujdive jashtëgjqësore me nr. 1136/16 e datës 08.06.2017, 1137/16 e datës 01.11.2026 dhe 1140/16 e datës 06.12.2016 të lidhur në mes të paditëses BKS me të dëmtuarit V.P. të cilët i përfaqëson i autorizuarin e tyre E.Q. nga Prizreni, të lidhura në Prishtinë, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësja BKS, me palët e dëmtuar ka arritur ujdj jashtëgjqësore për kompensimin e demit material në shumat prej 360.00 euro, 486.00 euro dhe 438.00 euro, dem ky i shkakuar nga i padituri Sh.Q. si pasoj e aksidentit të datës 08.08.2016.

Nga leximi i urdhër-transferve bankar të datave 09.06.2017, 30.01.2017 dhe 15.12.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu paditësja i ka kompenzuar palët e dëmtuara në aksidentin e shkakuar nga këtu i padituri Sh.Q. në shumat prej 360.00 euro, 486.00 euro dhe 438.00 euro, e cila shuma janë transferuar në llogari e të autorizuarit të tyre E.Q.

3. Baza Ligjore

Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077 përkatësisht neni 136 shprehimisht parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkakuar pa fajin e tij”*. Po ashtu neni 10 i **Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018)**, parasheh se *“Kompensimi i dëmit material dhe jo material bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve”*, ndërsa neni 18 i po këtij ligji ka paraparë se *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkakuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”*, ndërsa paragrafi 3 i këtij neni ka paraparë se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se i padituri Sh.Q. ka shkakuar aksident trafiku me automjetin Ford Sierrame targa me datë 08.08.2016. Deri te aksidenti kishte ardhur ku vozitësi i veturës Ford Sierra, i cili ishte nën ndikimin e alkoolit dhe narkotikëve, derisa ishte duke lëvizur përgjatë rrugës “ Papa Gjon Pali i II”, me të arritur në kryqëzimin me rrugën “Aleksadër Flemingu”, merë veprimi për kthinë djathtas , me ç’rast e humb kontrollin mbi veturë, duke i goditur veturat e parkuara të evidentuar si vetura, B,C dhe D, të cilave u ka shkakuar dëme materiale. Po ashtu, gjykata ka ardhur në përfundim se i padituri në kohën kur është shkakuar aksidenti i njëjti nuk ka poseduar mbulesë sigurie valide të automjetit, fakte ky i konstatuar nga konfirmimi i policës së sigurimit me numër TPL:3894645 e datës 09.11.2011, ku thuhet se vetura e tipit Ford Sierra me targa ka pasur validitet të policës së sigurimit nga data 08.11.2011 deri më datë 08.11.2012. Ndërsa në anën tjetër pjesëmarrësit tjetër në komunikacion përkatësisht palët e dëmtuar tashmë janë kompensuar në tërësi nga pala paditëse, apo se pala paditëse e kishte kompensuar personat e tretë përmes ujdisë jashtëgjqësore në shumën e përgjithshme prej 1,284.00 euro. Si rrjedhojë, i padituri Sh.Q. si shkakuar i

aksidentit, bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, duke vozitur nën ndikimin e alkoolit, pa mbulesë sigurie dhe pa patënshofer, fakte këto të konstatuar në raportin policor të aksidentit, e të pohuara nga vetë i padituri, për dëmin e shkaktuar të dëmtuarit (tashmë të paguar nga ana e palës paditëse), ka për obligim që të njëjtën shumë t'ia rimbursoi këtu paditëses. Andaj, bazuar në këto fakte, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret i padituri duhet të obligohet që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të paguajë shumën prej 1,284.00 euro.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën ligjore, gjykata vendosi duke u bazuar në kërkesën e palës paditëse dhe konform nenit 378 lidhur me nenin 382 par. 1 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së, lidhur me nenin 463 të LPK-së, pasi që pala paditëse nuk i ka kërkuar shpenzimet procedurale në mënyrë të specifikuar, përkundër faktit se ky aktgjykim është në favor të saj.

Nga të lartcekurat dhe bazuar nenin 136 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Ligji Nr.04/L-018, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:153047, 22.02.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.